



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
DREJTORIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË

KONCEPTI I GËRMIMIT ARKEOLOGJIK, FAZA 1 DHE 2, SI DHE SONDAZHI ARKEOLOGJIK, NË ZONAT ME NR. PASURIE 6/44, 6/53, 6/58, 6/76, 6/83, 6/111 (JASHTË RRETHIMT TË MOZAIKUT), NR. 6/381, 6/52, 6/55 (BRENDA RRETHIMIT TË MOZAIKUT) ZONA KADASTRALE NR. 8210, MOZAIKU I TIRANËS.

1. Përshkrimi i nevojës për kryerjen e gërmimit arkeologjik

- Zona e propozuar për gërmim arkeologjik dhe sondazh, gjendet në pronat me Nr. 6/44, 6/53, 6/58, 6/76, 6/83, 6/111 (jashtë rrethimt të Mozaikut) dhe Nr. 6/381, 6/52, 6/55 (brenda rrethimit të Mozaikut) zona kadastrale nr. 8210, pranë Mozaikut të Tiranës (Harta 1).
- Nevoja për kryerjen e gërmimit arkeologjik lind për shkak të evidentimit të potencialit të lartë arkeologjik të sondazheve të realizuara jashtë rrethimit të Mozaikut si dhe faktit që gërmimet arkeologjike të vitit 2008 brenda rrethimit, janë ende të pa përfunduara. Gjithashtu, nisur nga potenciali i evidentuar në pronën me nr. 6/111, ku në sipërfaqe gjendet një sasi e madhe qeramike si dhe gjurmë muresh, u pa e nevojshme kryerja e një sondazhi arkeologjik.
- Sipërfaqja e përgjithshme në të cilën parashikohen gërmimi arkeologjik dhe sondazhi arkeologjik shkon rreth 815 m², e cila përkon me hapësirën e planifikuar për Fazën 1 dhe Fazën 2 (Harta 2).
- Për realizimin e gërmimit arkeologjik si dhe sondazhit, në përputhje me vendimin e KKTKM, hartohet ky dokument mbi bazën e të cilit do të realizohet i gjithë operacioni arkeologjik.
- Sondazhet arkeologjike do të realizohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Shërbimit arkeologjik në bashkepunim me DRTK Tiranë.
- Financimi i gërmimit arkeologjik do të realizohet nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

- Baza ligjore e hartimit të këtij dokumenti është Ligji nr. 27/2018 Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, Vendimi i KKTKM për miratimin e raportit të sondazheve arkeologjike pranë Mozaikut dhe Rregullore e Arkeologut miratuar me vendim nr. 2 datë 30.01.2009 të KKA.

2. Metodologjia që do të ndiqet për kryerjen e gërmimit arkeologjik

- Sondazhet arkeologjik kryhen sipas Rregullores së miratuar nga KKA datë 30.01.2009.
- Para se të fillojë gërmimi arkeologjik, do të mbahet një procesverbal midis përfaqësuesve të DSHA/IKTK dhe DRTK - Tiranë.
- Gërmimi arkeologjik dhe Sondazhi arkeologjik do të kryhen me shtresa shumë të holla 10-15 cm duke patur parasysh specifikën e zonës, ku ka ndërhyrje të periudhave moderne dhe shpesh depozitat janë të pa qarta, sitje e dheut të dalë nga gërmimi dhe dokumentimi i të gjitha shtresave.
- Thellësia e gërmimit do të arrijë deri në shtresën e fundit me depozitim kulturor.
- Gërmimi arkeologjik, për efekt të organizimit do të realizohet në dy faza. Faza e parë lidhet me gërmimin brenda hapësirës së Mozaikut dhe Faza e dytë lidhet me hapësirën jashtë rrethimit aktual të tij, ku pjesë e saj është edhe sondazhi arkeologjik.

Gërmimi arkeologjik dhe Sondazhi do të kryhen sipas Rregullores së KKA datë 30.01.2009.

- Fillimi i aktivitetit arkeologjik, i cili do të marrë një numër rendor, duhet t'i raportohet IKTK/DASHA, 2 (dy) ditë para se të fillojë dhe dokumentohet me procesverbal të fillimit të punimeve, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesit e DSHA dhe DRTK Tiranë.
- Përfundimi i veprimtarisë arkeologjike duhet t'i raportohet brenda 3 ditëve IKTK/DSHA-s, e cila prezanton konkluzionet paraprake apo përfundimtare në mbledhjen e radhës të KKTKM dhe dokumenton me procesverbal përfundimin e GËRMIMIT arkeologjike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

3. Gërmimi arkeologjik dhe Sondazhi - Proceset e punës që do të kryhen nga arkeologët e DRTK dhe IKTK/DSHA dhe mënyra e raportimit

- Në total janë propozuar dy zona gërmimi arkeologjik në hapësirën brenda dhe jashtë Mozaikut, me sipërfaqe rreth 800 m² dhe 1 sondazh arkeologjik në formë trenchi me përmasa 10x1.5, dhe thellësi deri në shtresën e fundit kulturore, ku fillon të dalë dheu natyral.
- Përveç procesit të gërmimit me krahë të dheut sipas kuadrateve të përcaktuara më parë dhe sitjes së dheut, pjesë përbërëse e gërmimit arkeologjik është dokumentimi hap pas hapi i situatës përmes vizatimit në shkallë.
- Profilet 1:20
- Planimetri e përgjithshme 1:50
- Detajet (struktura, varre, etj) 1:1 deri 1: 10

Pritshmëria shkencore. Zona e parashikuar për kryerjen e gërmimit arkeologjik dhe sondazhit, bazuar në rezultatet e sondazheve të kryera në muajin Mars të vitit 2021 pritet të nxerrë në dritë vazhdimin e rrënojave dhe gjurmëve të Mozaikut të Tiranës, si në anën perëndimore ashtu edhe në atë jugore. Pritshëmritë më të mëdha janë në hapësirën e pronave nr. 6/44 dhe 6/53, ku me sa duket aktualisht, ndërhyrjet e periudhave moderne nuk kanë qenë të mëdha dhe kjo hapësirë është aktualisht lulishte. Sipas sondazheve të realizuara, del se strukturat e mozaikut vazhdojnë shtrirjen e tyre në të gjithë sipërfaqen e zonave me nr. pasurie 6/44, 6/53, 6/76 dhe 6/58 zona kadastrale nr. 8210, me një intensitet të konsiderueshëm dhe të ruajtura përgjithësisht mirë. Veçanërisht, bie në sy zbulimi për herë të parë i ambienteve të banimit të vilës ose siç njihet në literaturë si zona “pars urbana”, elementë të cilët nuk ishin identifikuar në gërmimet e mëparshme arkeologjike.

Gjithashtu, në hapësirën e planifikuar për gërmim brenda rrethimit aktual të Mozaikut përkatësisht në zonat me nr. Pasurie 6/381, 6/52, 6/55, ku ndodhet një prej pjesëve më të rëndësishme të vilës (pars rustica), me qëllim evidentimin e plotë të monumentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

- Brenda 3 (tre) viteve nga mbarimi i projektit duhet që këto rezultate të botohen.

6. Përpunimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të operacionit arkeologjik

Përpunimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të operacionit arkeologjik për dorëzimin në Arkiv, fillon paralelisht me punën arkeologjike në terren dhe përfundon mbas tij, si dhe përfshin:

a) Kontrollimin dhe plotësimin e të gjithë dokumentacionit që vjen prej operacionit arkeologjik, si:

- Kartelat e Njësive Stratigrafike
- Vizatimet e dorës të formatit A3, A4 dhe ato në Kartelat (si vizatime të profileve etj)
- Raportet e matjeve me sistemin e koordinatave.
- Hartimi i listave të gjetjeve arkeologjike, të Fotove, të Vizatimeve, të Kampioneve për analiza laboratorike nga dokumentacioni.
- Përpunimi i gjetjeve arkeologjike nëpërmjet larjes së tyre, tharjes, etikimit (mbishkrimin me tush) paketimi, të gjitha këto sipas Rregullores dhe rakordimi i tyre me listat e dokumentacionit. Këto procese i drejton arkeologu, në rastin më të mirë ai që merr pjesë në operacionin arkeologjik në terren.

b) Katalogizimi i Njësive dhe i Gjetjeve arkeologjike në bazën e të dhënave:

- Regjistrimi i gjetjeve sipas njësive stratigrafike dhe datimi i njësive stratigrafike
- Katalog i gjetjeve të imta/te veçanta

Kjo punë shkencore kryhet nga arkeologu me kualifikim të lartë. Në veçanti për hartimin e Katalogut të Njësive arkeologjike, në rastin më të mirë, ai që ka drejtuar operacionin arkeologjik.

c) Digitalizimi i vizatimeve të dorës (planimetri, pamje dhe prerje profilesh, dhe për raste të veçanta edhe tredimensionale). Ato kryhen prej specialistëve me përvojë në përpunimin e vizatimeve të operacioneve arkeologjike.

d) Hartimi i Raportit të gërmimit, i cili kryhet nga arkeologu me aftësi redaktuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

7. Fondet – Inventarizimi

Standardet e ruajtjes së materialeve arkeologjike (Fondet) dhe Konservimi i objekteve/strukturave

Të gjitha objektet arkeologjike të zbuluara gjatë GËRMIMIT arkeologjike janë pronë e shtetit shqiptar në bazë të Ligjit Nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Regjistrimi dhe depozitimi i tyre kryhet konform dispozitave të këtij ligji.

Materialet arkeologjike depozitohen pranë institucioneve shtetërore të specializuara sipas miratimit të KKTKM dhe përkohësisht pranë DRTK Tiranë.

- Të gjitha gjetjet duhet të pastrohen siç duhet për të siguruar jetëgjatësinë e tyre
- Gjetjet duhet të rregjistrohen në një data base sipas modelit të përcaktuar në Rregulloren e KKA-së.
- Gjetjet që do të depozitohen duhet të jenë të etiketuara siç duhet dhe me skedën shoqëruese. Gjithashtu, ato duhet të jenë të paketuara me materiale që sigurojnë jetëgjatësinë e tyre. Gjetjet përfaqësuese do të regjistrohen në kartelat përkatëse pranë IKRTK.
- Konservimi do të përfshijë si strukturat in situ ashtu edhe gjetjet e lëvizshme, që mund të restaurohen.
- Afati maksimal i dorëzimit të gjetjeve do të jetë 1 (një) vit nga data e përfundimit të GËRMIMIT arkeologjike.

8. Personeli dhe Afati i Realizimit

Personeli i projektit gërmimit arkeologjik duhet të përfshijë një tërësi profesionistësh të cilët do të bëjnë të mundur realizimin e plotë të gërmimit nga fillimi deri në fazën e fundit të tij, atë të botimit.

Personeli i përfshirë në një projekt të caktuar nuk duhet të ndryshojë deri në përfundim të tij, me përjashtim të shkaqeve të arsyeshme.

Personeli duhet të përfshijë, në varësi edhe të kapacitetit që kërkon gërmimi:

- a-) Drejtues projekti (Arkeolog IKTK/DSHA – **Mariglen Meshini**)
- b-) Bashkëdrejtues (Arkeolog-DRTK);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

- c-) Arkeologë (Teknikë gërmimi IKTK/DSHA-DRTK) me eksperiencë minimumi 3 – vjeçare;
- ç-) Specialistë për përpunimin e gjetjeve;
- d-) Konsulent shkencor me gradën Profesor Doktor;
- e-) Specialistë për konservim/restaurim (Restaurator **Olsi Plasa**);

9. Grafiku i detajuar dhe afatet kohore të realizimit:

- të gërmimit arkeologjik të shpëtimit si dhe sondazhit (40 ditë*)
- dokumentimit *in situ* (15 ditë njëkohësisht me sondazhin arkeologjike)
- konservimit/restaurim (30 ditë - 10 ditë njëkohësisht me gërmimin dhe 10 ditë pas përfundimit të gërmimit)
- inventarizimit të gjetjeve - (30 ditë nga përfundimi i gërmimit)
- hartimi i raportit paraprak i rezultateteve të gërmimit (15 ditë pas përfundimit të gërmimit arkeologjike)
- hartimi i raportit përfundimtar (30 ditë pas vendimmarrjes së KKTKM për raportin paraprak)
- në grafik do të parashikohen edhe afate kohore të nevojshme për të cilat do të kerkohen miratim nga KKTKM.

* ditët janë ditë pune

10. Lista e mjeteve dhe makinerive që do të përdoren në ëme specifikimet përkatëse.

- Kazma, lopata, karroca, mistri të vogla, kazma e lopata arkeologësh, furça e mjete të imëta gërmimi të nevojshme për gërmimin në rast evidentimi të varreve.
- Pozicionimet e kuadratëve dhe gjetjeve do të realizohen me GPS System.

11. Botimi dhe drejta e autorit

Botimi i “Raportit Përfundimtar”, sipas përcaktimeve të Rregullores së Arkeologut është e drejtë ekskluzive si dhe detyrim i DRTK dhe DSHA/IKTK, financimi i të cilit mbulohet nga institucioni. Me botimin e raportit përfundimtar, drejtuesi i projektit e humbet të drejtën e autorësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DRTK dhe DSHA/IKTK ka njëkohësisht edhe të drejtën e autorit për dokumentacionin dhe materialin që dorëzohet në arkiv apo fonde, si dhe të drejta ekskluzive për botimin e materialit brenda afateve të përmendura në vijim DRTK dhe DSHA/IKTK humbasin të drejtën e autorësisë mbi dokumentacionin dhe materialin e depozituar në rast mosbotimi brenda një periudhe prej 3 vjetësh.

Pas botimit të Raportit Përfundimtar, e drejta për botimin monografik është e hapur për të gjithë studjuesit dhe institucionet shtetërore dhe private, të cilët sigurojnë financimin e studimit dhe të botimit.

Autori/institucioni pretendues duhet t'i drejtohet KKTKM e cila ka tagrin e dhënies së kësaj të drejtë.

Përgatiti: Mariglen Meshini

Anisa Bejko – DRTK Tiranë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

2. Harta e gërmimit të propozuar.



3. Zona e sondazheve arkeologjike të realizuara jashtë rrethimit të Mozaikut në muajin Mars 2021..





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

4. Pamje e dokumentimit të strukturave të zbuluara gjatë sondazheve.



5. Harta e sondazheve arkeologjike të realizuara në muajin Mars 2021.